



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 103.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendimin i KQZ-së të datës 04.12.2009 për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave dhe vendimin e datës 14.12.2009 për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendet Komunale, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 05.03.2010 nxjerrë këtë:

VENDIM

Për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor të Zgjedhjeve Lokale të 15 nëntorit 2009

- I. Përmes këtij vendimi KQZ-ja vendos që materialin zgjedhor prej Zgjedhjeve Lokale të 15 nëntorit 2009 (zgjedhjeve komunale dhe për Kryetar të Komunave, zgjedhjeve të Raundit të II-të për Kryetar të Komunave të datës 13 dhjetor 2009 si dhe zgjedhjeve të përsëritura të Raundit të II-të për Kryetar të Komunave në Lipjan dhe Prizren të datës 31 janar 2010) ta asgjësojë/shkatërrojë përkatësisht ta mbaj/ruaj si në vijim:
 - a) **Fletëvotime të vlefshme/të pavlefshme/të zbrazëta/të dëmtuara.** Të gjitha fletëvotimet e vlefshme, të pavlefshme, të zbrazëta dhe të dëmtuara do të asgjësohen/shkatërrohen;
 - b) **Kopja dhe origjinali i Formularit të Përputhjes dhe Rezultateve (FPR)** për Zgjedhjet Lokale dhe Kryetar të Komunave të 15 nëntorit 2009 do të asgjësohen/shkatërrohen;
 - c) **Pakot e votimit.** Nga një (1) Pako e Votimit me material të papërdorur zgjedhor do të ruhet për qëllime trajnimi. Pakot e Votimit do të ruhen në Sekretariatit e KQZ-së;
 - d) **Vula zyrtare e Fletëvotimit/vulat tjera.** Vula zyrtare e Fletëvotimit dhe vulat tjera do të ruhen për përdorim në të ardhmen;
 - e) **Lista e Gjerë e votuesve për tërë komunën.** Një (1) kopje e Listës së Gjerë për secilën komunë do të ruhet në SKQZ. Pjesa tjetër do të asgjësohet/shkatërrohet;
 - g) **Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV) dhe Lista e Votuesve me Kusht (LVK).** Nga një (1) kopje e LPV-së dhe LVK-së do të ruhet në SKQZ për qëllime trajnimi. Tërë pjesa tjetër e LPV-së dhe LVK-së do të asgjësohet/shkatërrohet
 - h) **Librat e Votimit (Ditarët).** Faqet e përdorura nga Libri i Votimit do të ndahen dhe do të shkatërrohen. Pjesa tjetër do të ruhet për përdorim në të ardhmen;
 - i) **Fletëvotimet Përmes Postës.** Një (1) kuti e Fletëvotimeve Përmes Postës do të mbetet për qëllime të trajnimit. Të tjerat do të asgjësohen/shkatërrohen;
 - j) **Fletëvotimet me Kusht nga Serbia dhe Mali i Zi.** Një (1) kuti e Fletëvotimeve me Kusht nga Serbia dhe Mali i Zi do të ruhen për qëllime trajnimi. Të tjerat do të asgjësohen/shkatërrohen;
 - l) **Fletëvotimet e Papërdorura.** Një (1) pako e Fletëvotimeve të Papërdorura do të ruhet për qëllime të trajnimit. Pjesa tjetër e mbetur do të asgjësohet/shkatërrohet;
 - m) **Fletëvotimet e Trajnimit.** Të gjitha Fletëvotimet e Trajnimit do të ruhen në SKQZ për qëllime të trajnimit;
 - n) **Fletëvotimet me Kusht.** Pesë (5) kuti të Fletëvotimeve me Kusht do të ruhen për qëllime trajnimi. Të tjerat do të asgjësohen/shkatërrohen;

- o) **Formulari i Përputhjes dhe Rezultateve (FPR).** Originali dhe kopja e verdhë e FPR-së do të ruhet në SKQZ;
 - p) **Dosjet e Formularëve të Rezultateve.** Të gjitha Dosjet e Formularëve të Rezultateve do të ruhen në SKQZ;
 - q) **Zarfat e Bardhë të Fletëvotimeve me Kusht.** Të gjithë Zarfat e Bardhë të mbetur të Fletëvotimeve me Kusht do të ruhen për përdorim në të ardhmen;
 - r) **Zarfat e Fshehtësisë të Papërdorur.** Të gjithë Zarfat e Fshehtësisë të Papërdorur do të ruhen për përdorim në të ardhmen.
- II. Materiali zgjedhor që është objekt i hetimeve të KZAP-it, përjashtohet nga asgjësimi/shkatërrimi sipas këtij vendimi.
 - III. I gjithë materiali që është për t'u asgjësuar/shkatërruar i specifikuar në pikën I të këtij vendimi do të asgjësohet/shkatërrohet nën mbikëqyrjen e anëtarëve të KQZ-së dhe Komisionit të caktuar nga SKQZ-ja për këtë qëllim.
 - IV. Transporti i materialit zgjedhor për asgjësim/shkatërrim duhet të bëhet nën përcjelljen e Policisë së Kosovës.
 - V. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi brenda afateve të përcaktuara ligjore.
 - VI. Ky vendim hyn në fuqi me 05.03.2010

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

